

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Podvorica, duke vendosur në lëndën penale të pandehurit H. M. S. nga fshati P., Komuna e P., për shkak të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 285 par.1 të KPK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.nr.6550/2012 të dt.28.01.2013, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, të mbajtur në praninë e Prokurorit të shtetit Ajshe Ferati nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, dhe të pandehurit H. S., pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më dt.26.06.2016, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.07.03.2016 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: **H. S.**, nga i ati M. dhe nënës Z., e vajzërisë S., i lindur me *data e lindjes...* në fshatin M., tani me vendbanim në fshatin P., Komuna e P., ku edhe tani jeton, nr. personal *numër personal...*, ka të kryer Akademinë Pedagogjike, i pa punë, i martuar baba i 3 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në kuptim të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së

LIROHET NGA AKUZA

Sepse:

Më datën 23.08.2012, rreth orës 17:00, i pandehuri me qëllim vjedhje, në vendin e quajtur “Livadhi i F.” në Regjionin Ekonomiko Pyjor të Bellasicës, Komuna e Podujevës, me të cilin qeverisë Autoriteti Pyjor zyra në Prishtinë, me sharrë motorike, ka prerë 9 copë trungje, të llojit ahu, me gjatësi 16 m, diametër 25-40 cm, dhe vëllim të përgjithshëm 2.47 m³, me ç`rast Autoritetit Pyjor të Kosovës, zyra në Prishtinë, i ka shkaktuar dëm në vlerë prej rreth 333 €,-

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 285 par.1 të KPK-së.
- për shkak se nuk është provuar që i akuzuari të ketë kryer këtë vepër penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

E dëmtuara APK zyra në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën PP.nr.6550/2012 të dt.28.01.2013, ka akuzuar të pandehurin H. M. S. nga fshati P., Komuna e P., për shkak të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 285 par.1 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale kjo gjykatë ka treguar shqyrtimin kryesor gjyqësor më dt.26.02.2016, në të cilën u dëgjuan Prokurori i shtetit Ajshe Ferati nga Prokuroria Themelore

në Prishtinë, i pandehuri H. S., si dhe dëshmitari T. S..

Gjatë shqyrtimit gjyqësor Prokurori i shtetit Ajshe Ferati nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, ka përfaqësuar aktakuzën dhe në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se mbeten në tërësi pranë aktakuzës së ushtruar me shkrim kundër të pandehurit H.S. në drejtim të veprës penale me të cilën e ngarkon aktakuza, kjo vepër penale është vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarit T. S. i cili është roje pyllit në atë terren-pjesë, si dhe nga fletëparaqitja e rojës së pyllit e dt.23.08.2012, andaj i propozoi gjykatës që të njëjtin të shpalli fajtor dhe të dënoj sipas ligjit.

I pandehuri H. S., në mbrojtjen e tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka theksuar se është i pa fajshëm dhe se gjatë shqyrtimit gjyqësor do të vërtetohet se nuk e kam kryer veprën penale, duke deklaruar se me dt.23.08.2012, rreth orës 17:00, saktësisht në këtë kohë nuk e dije ku kam qenë, mirëpo kam qenë duke i sjellë drunj të prej malit tim në fsh.P. ku banoj. Drutë i kam prerë në pronën time private e cila është në emrin tim. Aty ku keni i kam prerë drutë afër pronës sime ka pronë shoqërore dhe kufizohet me pronën time private, mirëpo ne pronën shtetërore nuk ka lisa sepse ajo është shkatërruar tërësisht, dhe nuk ka fare lisa për të prerë dhe për këtë mund të verifikoni edhe ne vendin e ngjarjes, ndërsa ne pronën time ka ende lisa. Drunjët që kam prerë kanë qenë të damkosura, të cilat para së të prehen vulosen në rrënjën e lisit, dhe lirohet kubikazha se sa lejohet për të prerë në atë pjesë. Ditën kur më ka takuar roja e pyllit ato dru kanë qenë të vulosura me 23.08.2012, sepse ato i kam përgatitur për ti prurë ne shtëpinë time ne fsh. P..

Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se unë nuk e ndije veten fajtor, me vjen shumë rëndë dhe shumë keq ndaj prokurorisë dhe ndaj individëve të cilët me akuzojnë për padrejtësi të cilën mu ka bërë mua, andaj kërkoj nga gjykata që të me liroj nga akuza sepse jam i pafajshëm dhe kjo u vërtetua nga dokumentacioni të cilin i ofrova gjykatës dhe prokurorisë andaj në bazë të kësaj kërkoj nga gjykata që të më liroj nga akuza.

Gjykata ka administruar provat e propozuara: ka bërë dëgjimin e dëshmitarit T. S., si dhe u lexuan fletëparaqitja e rojës së pyllit nr. 36/2012 e dt.23.08.2012, procesverbali i dt.29.12.2011 i përpiluar nga Drejtoria e Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Podujevë sipas të cilit është konstatuar se në pronën private të H. S. janë prerë 37 copë trungje të llojit ahu, leja për bartjen e drunjëve të pyllit privat me nr. 000046 e dt.11.07.2012, e lëshuar nga Agjencia Pyjore e Kosovës, e nënshkruar edhe vetë nga roja e pyllit T. S., fletë damkosja e dt.04.07.2012 me nr. 001550 e lëshuar në Agjencinë Pyjore të Kosovës, si dhe shkresave tjera në lëndë.

I pandehuri me vërejtje në provat e administruara.

Gjykata pas procedurës së provave, vlerësimit dhe krahasimit të provave të administruara një nga një e të gjitha së bashku në lidhmëri në mes tyre, në mbështetje të dispozitave të nenit 8 dhe 361 të KPPRK-së, vërtetoi dhe gjeti këtë gjendjen faktike:

Se nuk është provuar se i pandehuri H. S., ka kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 285 par.1 të KPK-së, për të cilën akuzohet. Me provat e administruara pa dyshim është vërtetuar se vepra penale për të cilën akuzohet nuk është kryer nga ana e të pandehurit të lartcekur.

Deri te kjo gjendje faktike gjykata erdhi duke u mbështetur në mbrojtjen e të pandehurit H. S. i cili gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor e ka mohuar akuzën dhe kryerjen e veprës penale si

dhe nga deponimet e dëshmitarit T. S. si dhe provat materiale të administruara në shkresat e lëndës.

Nga dëshmia e dëshmitarit T. S., i cili në shqyrtimin gjyqësor në dëshminë e dhënë, në të cilën ndër të tjera ka deklaruar se me dt.23.08.2012, rreth orës 17:00, H. atë ditë e kam takuar te Livadhi i F.. H. ka qenë duke i marrë lisat të cilët kanë qenë të prerë e të cilët unë e dije se janë në pronën e shtetit. Te Livadhi i F. ka edhe pronë shtetërore edhe private. Vendi ku ka qene duke i ngarkuar drutë është prona private, ndërsa vendi ku janë prerë drutë mendoj se është pronë shtetërore, mirëpo nuk jam i sigurt ngase aty ka edhe pronë private. Po sipas kontrollës që është bërë nga organet kompetente ajo pronë mua me kanë thënë se është shtetërore. Se ato dru janë prerë ne vendin që ka qenë pronë shtetërore vërtetohet se aty ka mbetur shenjat e bartjes së drunjëve gjatë tërheqjes nga vendi ku janë prerë. Se ajo pjesë e pyllit është pronë shtetërore dëshmohet vetëm në bazë të thënieve nga kontrolli, ndërsa nuk kemi kurrfarë shenje apo harte e cila do të definonte pronën shtetërore nga ajo private. Sipas kontrolles ai teren ku janë prere drutë është prona shtetërore, mirëpo nuk jam i sigurt që është prona shtetërore pasi që nuk kam GPS-es apo hartë. Atë ditë kam biseduar dhe H. me ka thënë se është prona e tij private, ndërsa unë i kam thënë se është prona shtetërore. H. S. ka pronë te Livadhi i F., pyll por edhe livadh dhe dru për të prerë dhe është e vërtetë se disa herë ju ka prerë pylli i tij privat. Kur jam takuar me H. ai me ka thënë se kam dokumente mirëpo unë nuk i kam parë. Për çdo leje që epet ato dru duhet të jenë të damkosura.

Ndërsa në pyetjen: Se flet përcjellja për bartjen e drunjëve e dt.23.08.2012, kush e ka nënshkruar dhe i epet të sheh nënshkrimin dhe dëshmitari përgjigjet se unë e kam nënshkruar dhe gjithçka është në rregull.

Nga fletëparaqitja e rojës së pyllit të dt.28.07.2012, u vërtetua fakti se nuk janë dhënë të dhënat e sakta personale për të pandehurin i cili ka datëlindjen më dt.10.02.1978, e jo në vitin 1975 siç shkruan në fletëparaqitjen e rojës së pyllit.

Gjykata nuk i ka dhënë besimin deklaratës së dëshmitarit T. S., ku shprehimisht thotë se ai ka takuar të pandehurin ditën kritike, në vendin e cekur si në dispozitiv të aktakuzës, mirëpo nuk është i sigurt se ato dru të prera janë prerë në pronën shoqërore sepse nuk është i pajisur me GPS-es, për të përcaktuar saktë se vendi ku janë prerë drutë është pronë shoqërore apo private ngase aty ka edhe pronë private, andaj këtë e përcaktojnë vetëm në bazë të thënieve të kontrollit të tyre, meqenëse nuk kemi kurrfarë shenje apo harte e cila do të definonte pronën shtetërore nga ajo private. Gjykata nuk ia fali besimin deklaratës së dëshmitarit për arsye se e njëjta ishte në kundërshtim edhe me provat materiale të lëshuara dhe nënshkruara nga vet ai, për faktin se dëshmitari në pyetjen e gjyqtarit: Se fletë përcjelljen për bartjen e drunjëve të dt.23.08.2012, kush e ka nënshkruar dhe i është dhënë të sheh nënshkrimin në të dhe dëshmitari është përgjigjur se unë e kam nënshkruar dhe gjithçka është në rregull. Me çka dëshminë e tij e bënë të pabesueshme dhe të paqëndrueshme në provat materiale.

Gjykata ia ka dhënë besimin e plotë deklaratës se të pandehurit sepse i njëjti me deklaratën e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor ka vërtetuar se ditën kritike ka qenë duke bartur drutë nga prona e tij private, i cili në mënyrë bindëse ka sqaruar se ditën kritike nuk ka qenë në pyllin në pronë shoqërore për të prerë dru, për faktin se ka ofruar provat materiale të cilat dëshmojnë deklarimin e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor se i njëjti ka pasur leje për prerjen e drunjëve (trungjeve) në pyllin privat, në vendin e quajtur “Livadhi i F.”, në ngastrën kadastrale

nr.511, komuna kadastrale M., në sasi prej 24,32 m³, ku ka ofruar Lejen nr.000046 të dt.11.07.2012, të cilat dru kanë qenë të damkosura për çka edhe i është lëshuar Fletëdamkosja nr.10/001550 dt.04.07.2012, ndërsa për ditën kritike me dt.23.08.2012 i pandehuri ka pasur fletëpërcjelljen e lëshuar me dt.23.08.2012 nga personat zyrtar për bartjen e druve nga pylli i tij privat, andaj në një gjendje të tillë nuk ka mundur të jetë kryerës i veprës për të cilën akuzohet.

Gjykata pas analizës dhe vlerësimit të gjitha provave së bashku dhe të secilës veç e veç, nuk gjeti prova që provojnë se veprimet e të akuzuarit H.S. përmbajnë elemente të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 285 par.1 të KPK-së, meqenëse sipas bindjes së kësaj gjykate nuk u vërtetua se i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën akuzohet, prandaj e liroi nga akuzat në mungesë të provave e në bazë të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së.

Në bazë të nenit 454 par.1 të KPPRK-së, është vendosur që shpenzimet e procedurës penale të bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike u mor në kuptim të nenit 463 par.3 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e në kuptim të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË

P.nr.78/2013 më datë 07.03.2016

Gjyqtari:
Minir Hoti

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, prej ditës së pranimin të njëjtë. Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.